



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:167901

Datë: 04.11.2019

Numri i dokumentit: 00623042

P.nr.1025/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal në përbërje nga gjyqtari i vetëm gjykues Ertan Sejfulla, me bashkëpunëtoren profesionale Vahide Krasniqi në çështjen penale të akuzuarës H. G. nga P. të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2926/2014 të datës 19.03.2015, për shkak të veprës penale Lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 16.10.2019, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i shtetit Ajshe Ferati dhe i akuzuarit H. G. të njëjtën ditë, me datë 16.10.2019, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari H.G., i ati Sh. , i lindur me datë, me vendbanim në rrugën “L.”nr ... E. në P., më nr. personal, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me datë 21.02.2014 gjatë kontrollit të bërë nga ana e punëtorëve të autorizuar të KEDS-it, është konstatuar se i pandehuri me qëllim që vetës ti sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, në njëhisorin elektrik nr. 9230403, i vendosur në shtëpinë e tij ka bërë rikyqjen në rrjetin elektrik pa autorizim të KEDS-it edhe pse më parë ishte shkyçur nga rrjeti elektrik,-

- me këtë ka kryer veprën Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së nr.06/L-074.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: neneve 7,17,21,38,40,43,69 dhe 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së nr.06/L-074, si dhe nenit 365 të KPRK, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit H. G., i caktohet dënim në gjobë në shumën prej **250.00 €** (dyqind e pesëdhjetë), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij

aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do të zëvendësoj dënim në gjobë në dënim me burgim, ashtu që një ditë burgimi do t'i llogaritet me njëzet (20.00) € gjobë.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej **tridhjetë (30.00) €**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

Pala e dëmtuar: KEDSI-Prishtine, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet ne kontest te rregullt juridiko-civil

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.2926/2014 të datës 19.03.2015, ka akuzuar të pandehurin H. G. për shkak të veprës penale Lidhje e paautorizuar ne shërbime neni 321 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 16.10.2019, prokurori i shtetit në bazë të nenit 3 (Zbatimi i ligjit më të favorshëm) të KPRK-së, e rikualifikon në veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga nenin 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së nr.06/L-074. Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit i është dhënë fjala që të deklarohej lidhur me fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe i njëjti ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke shtuar se pendohet për veprën e bërë dhe se më nuk do të përsërisë vepra të tilla.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i akuzuari, Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë konform dispozitave të KPRK-së, si dhe në përputhshmëri me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj dhe ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese gjatë marrjes së dënimit.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndihet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria, gjykata me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga nenin 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së nr.06/L-074.

Gjykata vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata e shpalli fajtor të akuzuarit, pasi që më parë gjeti se janë penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprë penale të kryer; intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; pendimin për veprën e kryer, sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale; premtimin se nuk do të përsërisë vepra të tilla dhe faktin se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë

rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtor, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38, të KPRK-së, e që konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPRK-së.

Vendimin për kërkesën pasurore-juridike gjykata e bazoi në nenin 463 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 30.10.2019.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1025/15, datë 30.10.2019.

Bashkëpunëtorja profesionale,
Vahide Krasniqi

Gjyqtari,
Ertan Sejfulla

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.